



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE E MBROJTJES SOCIALE
SPITALI RAJONAL ELBASAN

Date 19.02.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “FURNIZIM VENDOSJE PAJISJE MJEKSORE PËR
SISTEMIN E REZONANCËS MAGNETIKE”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 33100000-1

**Fondi limit/ Vlera e pritshme e kontratave është 16,416,000 (gjashtembedhjetemilion e
katerqind e gjashtembedhjetemije) lekë pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Spitali Rajonal Elbasan ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

- a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*
- b. Lista e cmimeve të artikujve, sipas Shtojcës 2;*
- c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*
- d. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2020, 2021, 2022), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në nenin 43 pika 2/b, 43 pika 3 dhe 43 pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet:

Neni 43 pika 2/b

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.

Neni 43 pika 3

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Neni 43 pika 5

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, te Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet: *Çdo tatimpagues pergatit deklaraten vjetore te te ardhurave te tatueshme ne formen*

*e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore **brenda datës 31 mars të vitit pasardhës**,*

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2020, 2021, 2022) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit*

Shënim: Akti Ekspertizë e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c" të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku parashikohet se: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik"; si dhe Kreu V, Seksioni III, Nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr. 10091 datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" (i ndryshuar).

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e publikimit të njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit të lotit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën sa 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë dhe është në përputhje me përcaktimet e RRPP nëni 40 pika 4: “4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”

Është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën sa 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar (jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës).

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqese deklaratën mbi origjinën e mallit (*firma prodhuese ,vendi I prodhimit ,model I ofruar) per pajisjet spitalore”*.

Argumentimi: (Ky kriter vendoset me qëllim njohjen e origjinës së mallit dhe kompaninë prodhuese për të identifikuar në mënyrë të qartë atë gjatë lëvrimit të tij dhe për të pasur sigurinë që i njëjti mall i ofertuar do të lëvrohet në destinacion në përputhje me nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.ne te cilen eshte percaktuar: Pika 8 ” *Autoriteti/enti kontraktor ,pervec kerkesave te parashikuara ne kete nen ,mund te percaktoje kriteret e vecanta ne varesi te objektit qe prokurohet ,te cilat i vlereson te nevojshme per ekzekutimin me sukses te kontrates ” dhe keto kerkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontrates pra të garancise se furnizimit të mallit objekt prokurimi).*

1.3.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratën per periudhën e garancise se mallit , jo me pak se nje 1 vit garanci, duke perfshire blerjen dhe zevendesimin e pjeseve te difektuara me pjese kembimi te reja dhe origjinale, si dhe te gjitha sherbimet periodike parandaluese qe parashikon prodhuesi brenda periudhes se garancise. (kjo do te jete edhe kusht I kontrates ne rastin e shpalljes fitues)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku shprehet rrjedhimisht se *Autoriteti Kontraktor mund të hartojë kriteret në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontrates, si dhe pika 8 e po këtij neni në të cilën është përcaktuar : Pika 8. Autoriteti/enti kontraktor ,pervec kerkesave te parashikuara ne kete nen ,mund te percaktoje kriteret e vecanta ne varesi te objektit qe prokurohet ,te cilat i vlereson te nevojshme per ekzekutimin me sukses te kontrates*

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë/broshurë me të dhënat teknike për pajisjen e ofruar ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të hollësishme të kërkuara për këtë artikull. **Në katalogë, të markohen në mënyrë të qartë dhe të dallueshme specifikimet ,sipas modelit të deklaruar.** (*Katalogu duhet të ngarkohet në www.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT. Përshkrimi teknik duhet të jetë i përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe në pjesët që kanë lidhje me specifikimet teknike të kërkuara në DST*). Katalogjet do pranohen vetëm në formë elektronike nepermjet sistemit elektronik të prokurimit

Argumentimi: *Ky kriter është vendosur nga ana e Autoritetit Kontraktor me qëllim vertetimin se operatori ekonomik i plotëson kërkesat minimale në përputhje me nenin 40, pika 6 b) të VKM nr. 285 date 19.05.2021*“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. *ku shprehet rrjedhimisht: 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose ;

2.3.5 Operatori ekonomik duhet te paraqese nje Vetëdeklaratë, që pajisja e ofruar është e re, të një prodhimi origjinal

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku shprehet rrjedhimisht se *Autoriteti Kontraktor mund te hartojë kritere ne perpjesetim dhe te lidhura ngushte me aftesine zbatuese, natyren dhe vleren e kontrates, si dhe pika 8 e po ketij neni ne te cilen eshte percaktuar : Pika 8. Autoriteti/enti kontraktor ,pervec kerkesave te parashikuara ne kete nen ,mund te percaktojë kritere te vecanta ne varesi te objektit qe prokurohet ,te cilat i vlereson te nevojshme per ekzekutimin me sukses te kontrates*

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqese autorizim nga kompania prodhuese ose nga distributor i autorizuar nga prodhuesi për pajisjen e ofruar ku ne cdo rast te dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin për ofertim te pajisjes objekt i kësaj procedure .Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si telefon,faks,e-mail,ëbsite nevojshme për Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar ne pikat 2 dhe 4 te nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe piken 5 te nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ku eshte e cituar: Pika 5. ”*Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/entikontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojnë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Autorizimi per OE ofertues nga firma prodhuese ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit është një dokument i domosdoshëm për t’u paraqitur, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën/shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente dhe që vlerësohet nga ana e njësisë së prokurimit si e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim për tregtim të pajisjeve mjekësore, të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë, sipas ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”. Autorizimi duhet te jete i vlefshem ne kohen e zhvillimit te tenderit deri ne ekzekutimin e kontrates.

Argumentimi: Ky kriter eshte vendosur ne perputhje me piken 1 te nenit 77 te Ligjin nr. 162/2020 ”Per Prokurimin Publik”, ne te cilen gjejme te percaktuar se: *1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. Gjithashtu ky kriter është bazuar dhe në nenin 21, 22 dhe 23 të Ligjit Nr. 89/2014 “Për pajisjet mjekesore”.

- 1.3.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesi Certifikatën **ISO 9001:2015** mbi ” Sistemet e menaxhimit të cilësisë ” ose **EN ISO 13485:2016** mbi ” Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekesore ose ekuivalente, të prodhuesit, në përputhje me objektin e prokurimit. ose në rastin kur OE ofertues nuk është prodhues të paraqesë **Vetëdeklarim ku të deklarojë se furnizuesi është konform Standardeve të Cilësisë. Vetëdeklarimi do të verifikohet në procesin e vlerësimit të dokumentacionit, dhe në rastin e shpalljes fitues, OE do të dorëzojë Certifikatën në fjalë.**

Për këtë ai duhet të paraqesë certifikatën përkatëse brenda afatit të vlefshmërisë. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë Certifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit deri ekzekutimin e kontrates.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme është përcaktuar duke u bazuar në piken 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 ”Per Prokurimin Publik”, në të cilën gjejmë të përcaktuar se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, I plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

Si dhe në piken 1 të nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”ku përcaktohet se: *1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.*

2.3.9 Ofertuesi duhet të paraqesi Certificate konformiteti sipas direktives CE ose FDA ose ekuivalent, për të gjithë artikujt e ofruar, të perkthyer dhe noterizuar..

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar duke u bazuar në piken 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020”Per Prokurimin Publik”, në të cilën gjejmë të përcaktuar se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, I plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ I vlerësimi të konformitetit, I akredituar nga organizmi kombëtar I akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

Si dhe në piken 1 të nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”ku përcaktohet se: *1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, I plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ I vlerësimi të konformitetit, ia kredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.*

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertën teknike ,për pajisjen e kërkuar në formë të tabelave, ku të plotësohet: Specifikimet teknike të ofruara, Emri i kompanisë prodhuese, Origjina e mallit,Emertimi i katalogut të artikullit/produktit,Numrin e faqes ku ndodhet produkti,Numri I referencës së artikullit (kodi) nxjerre nga katalogu i prodhuesit,si dhe certifikimet përkatëse për produktin.

Argumentimi:Ky kriter është vendosur në përputhje me **piken 1 të nenit 36 të Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”**, në të cilën është përcaktuar se:

1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurorët.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë I nevojshëm transferimi I të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësitë kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

Gjithashtu ky kriter është në përputhje me piken 2 të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se:*Pika 2. Për mallrat që do të prokurorët, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, nëpërputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që I vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.*

Autoriteti Kontraktor nëpërmjet ofertës teknike, do të bëjë të mundur verifikimin me të sakte të artikullit të ofertuar, specifikimeve të tij, origjina, konformiteti etj me dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga ofertuesi.

2.3.11 Operatori ekonomik duhet te kete te punesuar te pakten 1 (nje) inxhinier te diplomuar ne nje nga profilet inxhinieri Elektronike / Elektrike / Mekatronike / IT / Biomedikal dhe te jete i trajnuar per instalim dhe servis te aparaturave biomjeksore. Per te punesuarin Inxhinier duhet të paraqesin diplomën, certifikatën e trajnimit, CV-në, kontratën individuale të punës. Ky punonjes do te jete personi pergjegjes per instalimin e aparaturave mjeksore dhe per trajnimin e stafit spitalor (mjeke,infermier,inxhinier) per perdorimin e sakte te aparaturave mjeksore.

Argumentimi: Bazuar në pikën 4, të nenit 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikave 4/b dhe 4/c të nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, për te provuar kapacitetet teknike dhe profesionale.

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Spifikimet Teknike

1. Bobinë MR Mame

- Bobinë e tipit të dedikuar për ekzaminimet MR për gjirin
- Brezi i aplikimit: gjiri
- Të ketë minimalisht 7 kanale
- Me mbulim të plote të hapësirës axiale bilaterale
- Me mundësi të kapjes së imazheve MR për të dy gjinjtë njëkohësisht
- Të jetë bobinë volumetrike me mundësi të pozicionimit të të dy gjinjve
- Të sigurojë cilësi imazhi të lartë
- Të ketë vëllim rigjido për një pozicionim me të sigurtë të pacientit
- Bobinë me peshë të lehtë që të sigurojë pozicionim të lehtë dhe të shpejtë të pacientit dhe bobinës
- E shoqëruar me pozicionues dhe imobilizues (nëse parashikohet nga prodhuesi), pozicionuesi i kokës i domosdoshëm
- Të punojë vetëm në regjimin digital marrës (receive)
- Të jetë kompatibël me Rezonancën Magnetike Multiva 1.5 T ose ekuivalente

2. Bobinë MR Radiocarpal

- Bobinë e tipit të dedikuar për ekzaminimet MR për dorën dhe kyçin e dorës
- Brezi i aplikimit: Dora dhe kyçi i dorës
- Të ketë minimalisht 4 kanale
- Të sigurojë cilësi imazhi të lartë
- Me mbulim afërsisht 10-30 cm të rajonit radiocarpal
- Të ketë vëllim rigjido për një pozicionim me të sigurtë të pacientit
- Bobinë me peshë të lehtë që të sigurojë pozicionim të lehtë dhe të shpejtë të pacientit dhe bobinës
- E shoqëruar me pozicionues dhe imobilizues (nëse parashikohet nga prodhuesi)
- Të punojë vetëm në regjimin digital marrës (receive)
- Të jetë kompatibël me Rezonancën Magnetike Multiva 1.5 T ose ekuivalente

3. Workstation MR

Workstation kompatibël për të marrë dhe përpunuar imazhet e marra nga Rezonanca Magnetike Multiva 1.5 T ose ekuivalente

Specifikimet Hardware

Workstation duhet të ketë minimalisht këto parametra, ose me te mira

Processor - Intel Xeon W-2145 3.7GHz ose ekuivalent

Memory 16GB

Hard drive - 256GB SSD

Hard drive - 1TB SATA

DVDWR Drive

Graphics card - NVIDIA Quadro P620 ose ekuivalent

Monitor – 24" Monitor, Kualitet i lartë FHD

Keyboard dhe Mouse

Sistemi Operativ - Windows 10

Specifikimet Software

Opsionet që duhet të jenë të instaluara

Ky workstation duhet të ketë te pakten këto paketa te instaluara :

1. MR MobiView IX
2. MR Substraction IX
3. MR Diffusion IX
4. MR T1 Perfusion IX
5. MR Echo Accumulation

1. MR MobiView IX

Opsioni MobiView në Viewer Multi-Modality kombinon automatikisht ("lidh") imazhe nga kapje të shumta nga i njëjti ekzaminim për të krijuar një vëllim të përgjithshëm.

Perfitimet Kryesore :

- Imazhet mund të shfaqen në pamjen 3D, në një volum unik MIP ose në formë pllake MPR.
- Seritë e imazheve mund të shfaqen, kryhen matje anatomike, prezantohen si film dhe të eksportohen duke përdorur ndërfaqe të përshtatshme DICOM.
- Opsioni MobiView mund të përdoret gjatë MRA të ekstremiteteve të poshtme, depistim i

metastazave në ekzaminimet total body, dhe për të shfaqur tërësisht Sistemin Nervor Qendror dhe shtyllën kurrizore.

2. MR Subtraction IX

MR Subtraction është një aplikacion post-procesim i cili mundëson llogaritjet bazike midis dy vëllimeve, ku përfshihet mbledhja, zbritja dhe raportin midis tyre në seri të vetme dinamike.

Përfitimet Kryesore :

- Aplikacioni ofron mundësinë për të kryer llogaritje të ndryshme për dy vëllime të referuara si burim (S) dhe referencë (R). Llogaritjet përfshijnë: zbritjen, shtimin dhe zbritjen relative të imazheve, si dhe llogaritjen e raportit midis tyre dhe raportit të transferimit të magnetizimit
- Bën të mundur të aplikohet një faktor peshimi për burimin dhe referencën, në varësi të llojit të llogaritjes
- Përmirësimi i kontrastit të imazhit të të dhënave MR duke zbritur seritë para aplikimit dhe pas aplikimit të kontrastit

3. MR Diffusion IX

4.

Aplikacioni MR Diffusion IX është projektuar për të ndihmuar në vlerësimin e të dhënave MR DWI (Diffusion Weighted Imaging) dhe DTI (Diffusion Tensor Imaging), për të analizuar difuzionin dhe vetitë anizotropike të indeve.

Ky aplikacion gjeneron harta parametrike duke përfshirë parametrat DËI standart dhe ADC/eADC

Përfitimet Kryesore :

- Aplikacioni përdoret për të karakterizuar vetitë difuzive të indeve në rastet të tilla si vlerësim i tunoreve dhe goditjen ishemi në tru
- Të dhënat DTI mund të ndihmojnë në analizimin e vetive anizotropike të indeve specifikisht të rëndësishme për lëndën e bardhë në tru ose në palcën kurrizore
- Për të dhënat DTI, mund të gjenerohen harta parametrike shtesë si Anizotropia Fraksionale FA, FA e drejtuar, difuziviteti aksial, difuziviteti radial dhe anizotropia relative.
- Regjistrimi, maskimi dhe shfaqja e serive të difuzionit MR është organizuar në mënyrë automatike për të krijuar dhe vizualizuar hartat parametrike menjëherë me fillimin e aplikacionit.
- Regjistrimi afinal i automatizuar i të dhënave hyrëse DWI korrigjon për artefakte të mundshme të lëvizjes.

5. MR T1 Perfusion IX

MR T1 Perfuzion është projektuar për të vlerësuar kthesat e intensitetit të kohës (TIC) të një serie të përmirësimit të sinjalit T1. Analiza e perfuzionit MR T1 prodhon imazhe të zbritura, si dhe rezultate numerike dhe grafike dhe harta parametrike të parametrave të mëposhtëm: përmirësimi relativ, përmirësimi maksimal, përmirësimi maksimal relativ, shkurtësia e përmirësimit, koha e mbërritjes (T0), koha në kulm (TTP), zona nën kurbë si dhe ëashin dhe out rate. Opaciteti i mbivendosjes përcaktohet nga përdoruesi. Regjistrimi i të dhënave burimore mund të heqë lëvizjen e pacientit. Zbutja kohore dhe hapësinore e të dhënave hyrëse mund të kryhet për të përmirësuar raportin e zhurmave SNR. Shikimi brenda aplikacionit lejon ruajtjen e pamjes aktuale si faqeshënues

Përfitimiet Kryesore :

- Aplikacioni paraqet sjelljen e vlerësimit T1 për rajone me interes përcaktuar nga përdoruesi ROI, në formën e një kurbe grafike dhe kuantifikon karakteristikat e kurbës, përfshirë ëahin-in dhe ëash-out
- Rezultatet e gjeneruara mund të shfaqen dhe të ruhen si harta parametrike, ose si mbivendosje në imazhet anatomike referencë. Opaciteti i mbivendosjes përcaktohet nga përdoruesi
- Shikimi brenda aplikacionit lejon përdoruesin të referohet çdo serie tjetër brenda të njëjtit studim (psh të dhënat e difuzionit), duke riformatuar automatikisht në të njëjtën geometri me serinë dinamike të ponderuar T1.
- Aplikacioni ka të përfshirë tabela me mundësi të selektimit me ngjyra për hartat parametrike.
- Regjistrimi i të dhënave burim, mund të eliminojë lëvizjet e pacientit që mund të ndodhin gjatë kapjeve dinamike
- Zbutja kohore dhe hapësinore i të dhënave mund të realizohet për të përmirësuar raportin e zhurmave SNR.
- Aplikacioni mundëson ruajtjen e pamjes aktuale si faqeshënues për përdorime të mëvonshme.

6. MR Echo Accumulation

MR Echo Accumulation mundëson llogaritjen e imazheve të reja bazuar në shumën e selektuar të koheve echo të serive me echo të shumëfishta. Përpunimi mundëson përditësim interaktiv të rezultateve. MR EA përdoret për të zhvilluar akumulimet pixelëise për seritë e imazheve me echo të shumëfishta. Ai mundëson gjithashtu, parashfaqjen, ruajtjen dhe analizën e serive të reja.

Përfitimiet Kryesore :

- MR EA përdoret për të zhvilluar akumulimet echo pixelwise
- Aplikacioni ofron mundësinë e kryerjes së akumulimit echo për seritë e imazheve me echo të shumëfishta.

- Aplikacioni mundëson llogaritjen e imazheve të reja bazuar në shumën e selektuar të koheve echo
- Është e mundur shfaqja paraprake e imazhit të gjeneruar nga seritë korente.
- Është e mundur gjenerimi dhe ruajtja e serive të reja të imazhit
- Aplikacioni ofron mundësinë për të përcaktuar diapazonin e akumulimit duke përdorur një rrëshqitës interaktiv

Specifikime të tjera

- Ky workstation duhet të jetë i dedikuar për përdorim klinik me një sistem të menaxhimit të imazheve me multimodalitete të avancuara të cilat duhet të suportojnë imazhet radiologjike në fushat e imazherisë, kardiologjisë, onkologjisë, neurologjisë, ortopedisë etj. Kjo pajisje duhet të ofrojë mundësinë e integritit të imazheve radiologjike nga vendor të ndryshëm në të njëjtin sistem dhe ndërfaqe softëerike.
- Konfigurimet standarte të këtij sistemi duhet të suportojnë të paktën :
 - o Kompatibilitet me vendor të ndryshëm ku mund të aksesohen imazhet radiologjike nga pajisjet MR, CT etj
 - o Udhërrëfyes të qartë softëerik të cilat lehtësojnë dhe tregojnë të gjithë etapat e procesimit të imazheve nga fillimi në fund
 - o Mundësi e përdorimit të mjeteve interaktive për të rritur eficensën dhe minimizimin e nevojës për trajnime të mëtejshme
 - o Vieëer multimodal për të shfaqur grup të dhënash nga MR, CT etj
 - o Shfaqje smart e të dhënave nga MR dhe cine loop
 - o Multimodalitet të Fuzioneve : MR-MR, CT-CT, CT-MR etj
 - o Regjistrim automatik MR-MR, CT-CT, CT-MR etj
 - o Shfaqje me multiframe e kapjeve sekondare
 - o Paraqitje e vellemeve ne 3D të modaliteteve MIP, VIP, minIP Surface MIP etj
 - o Aftësi e rishikimit të pllakave gjeneruar nga imazhet, përfshirë investigim rajonal dhe MPR
 - o Ekplorues i volumeve për segmentimet 3D interaktive dhe të menjëhershëm
 - o Modalitet Glass-Vieë për të shfaqur strukturat kockore në lidhje me volumet 3D
 - o Printim gjithëpërfshirës DICOM dhe kompatibilitet me DICOM 3.0

Me opsion te rritjes se performanës i cili mundëson upgrade të memorjes RAM nga 16GB drejt 32GB

Përfitimet kryesore :

- Aplikacioni mundëson kryerjen e matjeve të ndryshme (diametri intra-luminal, sipërfaqja lumenit ndërsektoriale, përdredhja e segmenteve vazale etj), për stenozat dhe aneurizmat në mënyrë automatike dhe manuale.
- Matjet mund të krijohen, ruhen dhe rishikohen

Mjete software automatike sic jane eliminuesi i kockave, trajektorja e navigimit, etiketimi i vazave, konturet e jashtme dhe të brendshme të lumenit për të thjeshtuar rrjedhën e punës

Përfitimet kryesore :

- Ndërfaqe intuitive
- Ruajtje e automatizuar e dizenuar për të dhënë rezultate në kohë më të shkurtër
- Mekanizëm i ri i kontureve të lumenit për inspektimet vazale

Aplikacioni multimodal AVA për vizualizimin, vlerësimin, dhe kuantifikimin e enëve të gjakut nëpërmjet të dhënave CTA dhe MRA në të njëjtën ëorkfloë për të dy modalitetet. Për të dhënat CTA, ai siguron nxjerrjen automatike të segmentimit të vijave qendrore të vazave , kontureve të lumenit dhe kontureve vaskulare. Për të dyja modalitetet, ai ofron mjete për nxjerrjen dhe redaktimin e vijave qendrore. MM AVA ofron pamje inspektimi për analiza lokale dhe për një pasqyrë të linjës qendrore të zgjedhur të vazave. Ai lejon krijimin, ruajtjen dhe rishikimin e matjeve bazë vaskulare, si dhe planifikimin e rrugës së hyrjes.

Përfitimet kryesore :

- Aplikacioni ofron mjete për vizualizimin, vlerësimin dhe matjet e enëve të gjakut në të dhënat CTA dhe MRA, për leziona të ndryshme vaskulare
- Aplikacioni kryen heqjen e kockave, nxjerrjen dhe segmentimin e enëve të gjakut (përfshirë vizualizimin 3D), në mënyrë automatike ose gjysmë automatike.
- Aplikacioni u mundëson përdoruesve të kapin dhe etiketojnë gjetje të shumta, me aftësinë për të lundruar ndërmjet tyre.
- Aplikacioni u mundëson përdoruesve të eksportojnë raporte të personalizueshme në Sistemin e Informacionit të Radiologjisë (RIS) ose PACS dhe të printojnë rezultatet në një raport të personalizuar. Përmirësime për versionin 12: MM AVA tani ofron:
- Një rrjedhë e re, e thjeshtuar e punës që minimizon hapat e rrjedhës së punës, e krijuar për të përshpejtuar punën tuaj të analizës ndërkohë që vazhdon të mbështesë vendimin klinik, si rritja e automatizuar e linjës qendrore me dy pika • Algoritmi i ri i përmirësuar plotësisht automatik i heqjes së kockave të kokës dhe qafës dhe nxjerrjes së enëve (përfshirë nxjerrjen automatike e arterieve subklaviane)

Multimodaliteti i gjurmuesit të tumoreve MMTT është një aplikacion post-përpunimi me shumë modalitete që përdoret për të shfaqur, përpunuar, analizuar dhe përcaktuar sasinë e imazheve anatomike dhe funksionale për një studim të vetëm ose gjatë rrjedhës së disa pikave kohore.

Përfitimet kryesore :

- Mbështet CT, MR, PET/CT, SPECT/CT, Dual Energy CT dhe Spectral CT
- Shikimi gjatësor i deri në tetë studime

- Regjistrim automatik dhe manual ndërmjet serive
- Segmentimi i indeve gjysmë automatike ose manuale
- Mjetet e redaktimit të segmentimit dhe përhapja përgjatë pikave kohore
- Kuantifikimi i lezionit duke përdorur llogaritjen automatike të matjeve të zgjedhura
- Llogaritja automatike e kritereve të zakonshme të përgjigjes në lidhje me onkologjinë
- Llogaritja e glukozës SUV për skanimet PET

Të gjitha pajisjet duhet të jenë të reja dhe të shoqërohen me materialet e domosdoshëme, manuale përdorimi, skica teknike etj, ku të jenë qartësisht të pasqyruara të dhënat e pajisjeve (*Prodhuesi, Modeli, Nr. Serie, Viti Prodhimi etj*), të cilat duhet të jenë gjithashtu pjesë e etiketave të vendosura në pjesët e dukshme të pajisjeve

Të gjitha pajisjet e kërkuara duhet të jenë të përshtatshme teknikisht për t'u instaluar me sistemin aktual të Rezonancës Magnetike e tipit Philips Healthcare Multiva 1.5 T ose ekuivalente.

Të gjitha pajisjet e kërkuara duhet domosdoshmërisht të plotësojnë standartet kryesore të prodhimit dhe tregtimit të pajisjeve mjeksore bazuar në legjislacionin përkatës.

Afatet e levrimin : Njësia referuar relacionit të përlllogaritjes së fondit limit përcaktoi kohëzgjatjen si më poshtë : **Brenda 30 diteve nga nënshkrimi i kontrates .**

Sasia dhe Grafiku I levrimin : jane vendosur ne perputhje me piken 1 te nenit 40 te **VKM-se Nr. 285, date 19.05.2021** “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen gjejme te percaktuar se: *1. Në procedurat e prokurimit për mallra, autoriteti/enti kontraktor parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë, si dhe grafikun e lëvrimin të mallrave.*

Në lidhje me kushtet e veçanta për kualifikim, njësia bazuar në rregullat e prokurimit publik të referueshme, në raport me shumën dhe shërbimin e kërkuar përcaktoi këto kritere si minimumin e kërkuar për t'u plotësuar nga operatorët ekonomikë.

Njesia e prokurimit, referuar nenit 49 pika 3 të ligjit Nr. 162/2020 datë 23.12.2020 përcaktoi afatet e dorëzimit dhe hapjes të ofertave si me poshtë :

Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje apo hapjen e tyre : 11.04.2024 Ora: 10:00 www.app.gov.al